



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 534/7 prot.

Datë 30.03.2026

**V E N D I M**

**Nr.442/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “inAuto” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73301-12-24-2025, me objekt: “Blerje motoçikletash për Policinë e Shtetit”, me fond limit 34,359,316.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 28.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës mbi ankesën e pranuar të operatorit ekonomik “Moto Tirana” SHA në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73301-12-24-2025, me objekt: “Blerje motoçikletash për Policinë e Shtetit”, me fond limit 34,359,316.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 28.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Moto Tirana” SHA me NIPT K21512004G dhe adresë: Bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë.

Operatori ekonomik “inAuto” SHPK me NIPT M31417021V dhe adresë: Bashkia Tirane, Njesia

Administrative Nr. 11, Rruga “Gjoke Doci”, Numri i pasurise 630/449, Zona Kadastrale 832, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a  
Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

**Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “inAuto” SHPK me NIPT M31417021V dhe adresë: Bashkia Tirane, Njesia Administrative Nr. 11, Rruga “Gjoke Doci”, Numri i pasurise 630/449, Zona Kadastrale 832, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2.Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat janë për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj ato duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomik kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 29.12.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73301-12-24-2025, me objekt: “Blerje motoçikletash për Policinë e Shtetit”, me fond limit 34,359,316.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 28.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 28.01.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 11.02.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

inAuto	32,361,000 lekë	Kualifikuar
Moto Tirana	34,289,987 lekë	Kualifikuar

II.4. Në datën 17.02.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 20.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6346 dhe nr.534/2026 prot, datë 20.02.2026 i operatorit ekonomik “Moto Tirana” SHA, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73301-12-24-2025, me objekt: “Blerje motoçikletash për Policinë e Shtetit”, me fond limit 34,359,316.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 28.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “inAuto” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në

bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 534/1 prot., datë 23.02.2026.

II.7. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në datën 25.02.2026, operatori ekonomik "inAuto" SHPK, në cilësinë e subjektit të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP-së ka paraqitur formularin e argumentave, formulari i cili është protokolluar me tonën me nr.534/2 prot., datë 26.02.2026.

II.8. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në datën 03.03.2026, autoriteti kontraktor, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr. 32/2026, datë 03.03.2026 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik, "Moto Tirana" SHA. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur pranimin e plotë të saj, duke argumentuar:

*II.1 Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimes "MOTO TIRANA" sha mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga OE "inAuto" shpk, ku argumentohet se: "...Nga verifikimi i historikut të aktivitetit të shoqërisë inAuto, përfshirë të dhënat zyrtare të regjistruara pranë institucioneve shtetërore Competente, rezulton se veprimtaria e tyre është e fokusuar ekskluzivisht në tregtimin e automjeteve dhe se aha nuk ksnë ushtruar aktivitet në fushën e shtitjes apo furnizimit me motoçikleta... ", KSHA arsyeton se:*

*Në Dokumentat Standarte të Tenderit të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimi, në Shtojcën 8, Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, është përcaktuar se:*

**OFERTUESI DEKLARON SE:**

*a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;....*

*KSHA konstaton se mbështetur në objektin e prokurimit si dhe referuar Specifikimeve Teknike të parashikuara sipas Shtojcës 6 të DTS, natyra dhe objekti i kontratës ka të bëjë me furnizimin me motoçikleta.*

*Lidhur me pretendimin e ankimesit se "Ne kemi bindje se shoqëria inAuto shpk nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, pasi kjo shoqëri sipas ekstraktit të aksesueshëm në faqen e QKB-së <https://qkb.gov.al/kerko-per-subjekt/> rezulton të mos ketë objektin e tregtisë së moto-mjeteve ku përfshihen edhe objekti i procedurës së prokurimit", KSHA pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Operatori ekonomik "inAuto" shpk në SPE arsyeton se:*

*Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, "Shkaqet e përjashtimit", gërma "A" "Deklarata për përmbushjen e kriteve të përgjithshme të kualifikimit", Operatori ekonomik "inAuto" shpk ndër të tjera ka deklaruar:*

*"Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme InAuto SHPK është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.*

*Adresa ëeb: Informacioni i nevojshem mund te merret nga Qendra Kombetare e Biznesit <https://qkb.gov.al>; <https://e-albania.al>*

*Autoriteti ose organi leshues: Qendra Kombëtare e Biznesit*

*Lloji i dokumentit: Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" dhe Ekstrakti historik për të dhënat e subjektit "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", Certifikatë Regjistrimi*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga shoqëria në rast se kualifikohet i pari ose në cdo rast që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor."....*

*Nisur nga përkufizimi ligjor, KSHA gjykon se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor ka detyrimin ligjor që të shqyrtojë e të vlerësojë ofertat sipas dokumentacionit provues të paraqitur nga OE në momentin e ofertimit. Rrjedhimisht çdo ndryshim oferte nga ofertuesi apo çdo kërkesë për ndryshim me qëllim kualifikimi përbën në vetvete modifikim të ofertës, ku referuar Nenit 92, pika 2 të LPP-së nuk lejohet.*

*Pra, për sa më sipër cituar, në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe në momentin e paraqitjes së ofertave, operatori ekonomik i shpallur fitues nuk e kishte të përfshirë në ekstraktin e tij tregtar fushën e veprimtarisë që lidhet me objektin konkret të prokurimit. Ky fakt është lehtësisht i verifikueshëm nga dokumentacioni zyrtar i regjistrimit tregtar dhe përbën një element thelbësor për vlerësimin e ligjshmërisë së kualifikimit të tij. Aftësia për të ushtruar një veprimtari të caktuar nuk është një element formal apo deklarativ, por një kusht ligjor që buron nga regjistrimi i subjektit në organet përkatëse. Objekti i veprimtarisë i përcaktuar në ekstraktin e regjistrimit tregtar përfaqëson kufirin juridik brenda të cilit subjekti është i autorizuar të operojë. Për rrjedhojë, nëse në momentin e ofertimit operatori nuk e kishte të përfshirë aktivitetin që përkon me objektin e kontratës, ai nuk ishte juridikisht i autorizuar për ta ushtruar atë veprimtari dhe, si pasojë, nuk plotësonte kriteret e pranueshmërisë në procedurën e prokurimit, objekt ankimimi.*

*Parimi themelor në prokurimin publik është që kriteret e kualifikimit duhet të përmbushen në momentin e dorëzimit të ofertës. Procedura e prokurimit është një garë që zhvillohet mbi bazën e kushteve të barabarta dhe të verifikueshme në një pikë të caktuar kohore. Nuk është e lejueshme që një operator ekonomik të plotësojë apo të korrigjojë mungesa thelbësore pas hapjes së ofertave, e aq më pak gjatë fazës së shqyrtimit të ankesës. Lejimi i një praktike të tillë do ta zhvendoste momentin e përmbushjes së kriterëve nga koha e ofertimit në një fazë të mëvonshme, duke cenuar sigurinë juridike të procesit. Nga dokumentacioni i paraqitur gjatë fazës së ankimimit rezulton se operatori ekonomik e ka shtuar fushën e veprimtarisë në ekstrakt vetëm pasi është paraqitur ankesa, si pjesë e paraqitjes së argumentimeve përkatëse. Ky ndryshim, i kryer pas zhvillimit të tenderit, nuk mund të ketë efekt prapaveprues dhe nuk mund të shërbejë për të legjitimuar një gjendje juridike që nuk ekzistonte në momentin vendimtar të ofertimit. Në të kundërt, do të pranohej në mënyrë implicite që kriteret e kualifikimit mund të plotësohen edhe pas shpalljes së fituesit, gjë që bie ndesh me parimet e transparencës, barazisë së trajtimit dhe konkurrencës së ndershme.*

*Kjo situatë nuk përbën një mangësi formale apo një pasaktësi dokumentare që mund të korrigjohet, por një mungesë thelbësore që lidhet drejtpërdrejt me kapacitetin ligjor të*

operatorit për të realizuar objektin e kontratës. Ndryshimi i objektit të veprimtarisë gjatë fazës së ankimimit përforcon pikërisht faktin se në momentin e ofertimit kjo veprimtari nuk ishte e përfshirë dhe, për rrjedhojë,

nuk ishte e autorizuar. Pranimi i këtij ndryshimi si i vlefshëm do të krijonte një precedent të rrezikshëm, duke i vendosur operatorët ekonomikë në kushte të pabarabarta.

Në rastin konkret, zgjerimi i objektit të veprimtarisë së shoqërisë pas procesit të ofertimit, konsiderohet si një përpjekje për të modifikuar ofertën me synimin e qartë për ta kthyer atë nga një ofertë e pavlefshme në të vlefshme, çka bie në kundërshtim me parimet e sanksionuara në legjislacionin e prokurimit publik.

Për më tepër, referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Operatori ekonomik i shpallur fitues paraprak, ka deklaruar, nën përgjegjësi të plotë ligjore, se përmbush të gjitha kriteret e kualifikimit dhe se disponon kapacitetin ligjor për të realizuar objektin e kontratës. Në kushtet kur në datën e ofertimit aktiviteti përkatës nuk figuronte në objektin e veprimtarisë së regjistruar, rezulton se deklarimi i bërë në formular nuk përputhej me gjendjen reale juridike të operatorit në atë moment, duke qenë rrjedhimisht i pasaktë. Gjithashtu, fakti gjatë fazës së ankimimit, operatori ekonomik "inAuto" shpk, ka shtuar fushën e veprimtarisë në ekstraktin tregtar e bën të pavlefshëm deklarin përkatës sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në momentin e zhvillimit të procedurës, objekt ankimi.

Në përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave citon se, Operatori ekonomik nuk plotësonte kriteret e kërkuara në momentin e paraqitjes së ofertës, ndërsa deklarimi i bërë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton i pasaktë në raport me gjendjen ligjore ekzistuese. Shtimi i mëvonshëm i fushës së veprimtarisë gjatë fazës së ankimimit nuk mund të shërbejë për të legjitimuar një mungesë thelbësore dhe as për të korrigjuar një deklarin që në momentin e dhënies së tij ishte i pasaktë.

### ***Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimes qëndron.***

II.2 Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimes "MOTO TIRANA" sha mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e Operatorit ekonomik "inAuto" shpk ku argumentohet se: "... Mallrat e furnizuara nga kompania inAuto nuk përmbushin kriterin në lidhje me furnizimet e ngjashme dhe zërat e mallrave të paraqitura nga kjo kompani nuk mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit ...", KSHA arsyeton se:

Në Dokumentet Standarte të Tenderit të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1, është përcaktuar se:

"1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

**a.** Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**b.** Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në

*fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*..... Pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit provues të paraqitur për përmbushjen e kërkesës për përvojën e ngjashme, rezulton se shoqëria "inAuto" shpk ka kryer furnizime për automjete në emër dhe për llogari të institucioneve publike. Kjo përvojë e ngjashme e dëshmuar nga ky Operator ekonomik lidhet ngushtësisht me objektin e ushtrimit të veprimtarisë së kësaj shoqërie, evidentuar kjo nëpërmjet Ekstraktit historik lëshuar gjatë momentit të ofertimit si dhe shqyrtimit e vlerësimit të ofertave. Referuar këtij dokumenti, Objekti i kësaj shoqërie lidhet me shitjen e automjeteve të reja dhe të përdorura, automobila, furgona, kamionë, autobusë, mjete të rënda pune, eskvatore, fadroma kamiona dhe agregate ne perdorimin e tyre, koka prerese dhe pajisje shtese, per funksione specifike nga automjetet ne fushen e ndertimit, automjete per perdorim te vecante, automjete per trajtimin e mbetjeve, mjete dhe automjete bujqesore, automjete industriale, aktivitet koncesionar dhe përfaqësim i markave të ndryshme, shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje automjetesh dhe mjete të rënda, autoriparim, servis i rregullt, pjesë këmbimi, lubrifikante dhe aksesore automjetesh, shitje me shumicë dhe pakicë e pjesëve të këmbimit, tregtimi i gomave me shumicë dhe pakicë, këshillim për blerje, leasing dhe financim automjetesh, pjesëmarrje në tendera dhe kontrata publike, import dhe eksport automjetesh dhe pjesësh këmbimi, sallone dhe ekspozita automjetesh, transport dhe logjistikë automjetesh, qiradhenie automjetesh trajnime dhe certifikime për personelin teknik.*

*Gjithashtu, nga një analizë krahasimore, rezulton se shoqëria "inAuto" shpk ka kryer furnizime për automjete dokumentuar kjo nëpërmjet faturave elektronike të paraqitura nga ky Operator nga ku evidentohen qartë zërat e artikujve për kontratat publike të deklaruara.*

*Theksojmë se në Specifikimet Teknike të parashikuara sipas Shtojcës 6 të DTS, si dhe referuar Shtojcës 7 të DST, ku janë përcaktuar artikujt e kërkuar, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar se natyra dhe objekti i kontratës së prokurimit ka të bëjë me furnizimin me motoçikleta.*

*Për sa më sipër, KSHA vlerëson se përvoja e ngjashme, si kriter thelbësor kualifikues, duhet të jetë në përputhje me të plotë dhe të drejtpërdrejtë me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, duke ecur paralelisht me të. Kapaciteti ligjor dhe teknik i Operatorit ekonomik kufizohet qartazi nga objekti i veprimtarisë i regjistruar në Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar.*

*Për rrjedhojë, një Operator ekonomik nuk mund të pretendojë apo të provojë përvojë të vlefshme në fusha që tejkalojnë objektin e tij të regjistruar, pasi theksojmë se kjo do të binte ndesh me parimin e sigurisë juridike dhe me vetë konceptin e kapacitetit profesional.*

*Në rastin konkret, rezulton se objekti i prokurimit nuk është i përfshirë në objektin e veprimtarisë së shoqërisë "inAuto" shpk. Për pasojë, dokumentacioni i paraqitur prej saj në funksion të provimit të përvojës së ngjashme nuk plotëson kërkesën për përputhshmëri materiale me objektin e prokurimit, sipas zërave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarte të prokurimit Mungesa e kësaj përputhshmërie përbën një mangësi thelbësore, e cila ndikon drejtpërdrejtë në vlerësimin e kapacitetit teknik dhe profesional të Operatorit ekonomik.*

*KSHA konstaton se, referuar objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, kjo e fundit nuk ka mundur të provojë përmbushjen në mënyrë kumulative të tre elementëve të përvojës së ngjashme, të parashikuara sipas Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 4. Për më tepër, pranimi i një oferte që nuk përmbush kriteret e vendosura do të çënonte drejtpërdrejtë parimin e barazisë në kuptim të trajtimit të barabartë të Operatorëve ekonomik*

si dhe transparencën e procedurës, duke krijuar një avantazh të padrejtë në raport me Operatorët ekonomik që kanë përmbushur në mënyrë të plotë dhe rigorozë kërkesat e parashikuara nga Autoritetit Kontraktor.

Në përfundim, mosplotësimi qoftë edhe i njërit prej kritereve të vendosura nga Autoriteti Kontraktor sjell si pasojë pavlefshmërinë e ofertës, pasi Operatori ekonomik ka detyrimin ligjor të paraqesë dokumentacion të plotë, të saktë dhe në përputhje me dokumentet e tenderit. Çdo devijim nga këto kërkesa përbën shkak të mjaftueshëm për skualifikim.

**Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.**

II.3 Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues "MOTO TIRANA" sha mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e Operatorit ekonomik "inAuto" shpk ku argumentohet se: "... Shoqëria inAuto shpk Çertifikatën ISO 9001:2015 "Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë" (e vlefshme) ose ekuivalente nuk e ka në përputhje me objektin e prokurimit, pasi organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë për të lëshuar këtë certifikatë i referohen objektit të veprimtarisë së subjekteve duke u bazuar në Ekstraktin e shoqërisë, objekt veprimtarie i cili nuk rezulton në këtë ekstrakt...", KSHA arsyeton se:

Në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 4, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar se: "4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001:2015 "Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë" (e vlefshme) ose ekuivalent."

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se qëllimi i kërkesës për paraqitjen e certifikatës ISO 9001:2015, nuk është vetëm dorëzimi formal i një dokumenti, por është provë e zbatimit të një Sistemi të Menaxhimit të Cilësisë, lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë e cila duhet të jetë e vlefshme në momentin e paraqitjes së ofertës.

ISO 9001:2015, si një standart ndërkombëtar përcakton kërkesat për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të cilësisë, duke garantuar kontrollin e proceseve, menaxhimin e riskut dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës organizative.

Në kuadër të vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se certifikata e paraqitur nga Operatori ekonomik duhet të përmbushë në mënyrë kumulative këto kushte:

të jetë lëshuar nga një organ certifikues i akredituar sipas legjislacionit përkatës;

të mbulojë në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë fushën e veprimtarisë që lidhet me objektin e prokurimit;

të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim Çertifikatën ISO 9001:2015 të paraqitur në SPE nga Operatori ekonomik "inAuto" shpk, konstatoi se kjo Çertifikatë është e zbatueshme në fushën e mëposhtme të aktivitetit të saj: "Import - eksport, tregtim dhe shpërndarje, pjesë këmbimi për mjete motorrike, lubrifikantë, goma, bateri, automjete, automjete të rënda, industriale e teknologjike, gjeneratorë, transformatorë, sisteme sigurie, pajisje elektrike, elektronike, industriale, hotelerie e mobilimi për të gjitha fushat e përdorimit. Furnizim, riparim dhe mirëmbajtje për të gjitha tipet e mjeteve lëvizëse e lundruese. Projektim, Supervizion dhe Punime në infrastrukturën civile e industriale."

*Për sa më sipër, KSHA vlerëson se çertifikimet e Operatorëve ekonomik, lëshohen në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë të pasqyruar sipas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar. Ndodhur në kushtet ku objekti i prokurimit, nuk përfshihet në objektin e veprimtarisë së shoqërisë (fakt ky i evidentuar nëpërmjet Ekstraktit Historik), logjikisht dhe automatikisht ky objekt prokurimi nuk përfshihet në objektin e Çertifikatës ISO 9001:2015.*

*Në rastin konkret, referuar përmbajtjes së Çertifikatës ISO të paraqitur nga shoqëria "inAuto" shpk, rezulton se fusha e veprimtarisë së pasqyruar në këtë certifikatë nuk përfshin aktivitetet që lidhen me objektin e prokurimit, i cili ka të bëjë në vetvete me furnizim motoçikletash.*

*Në këtë mënyrë, kjo certifikatë e paraqitur nga Operatori ekonomik nuk përmbush funksionin provues për të cilin është kërkuar duke mos garantuar në këtë mënyrë kapacitetin organizativ dhe teknik për realizimin e kontratës me sukses.*

*Në përfundim, KSHA gjykon se duke qenë se kushtet në lidhje me certifikimin duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe të plotë, mospërputhja materiale e fushës së çertifikimit me objektin e prokurimit, çënon parimin e proporcionalitetit e për rrjedhojë mosplotësimi i këtij elementi nuk mund të konsiderohet si mangësi formale apo e korrigjueshme.*

*Për sa më lart, KSHA konstaton se Operatori ekonomik "inAuto" shpk nuk ka mundur të provojë përmbushjen e kriterit për paraqitjen e Çertifikatës ISO 9001:2015 në përputhje materiale me objektin e prokurimit.*

#### ***Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.***

*II.4 Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues "MOTO TIRANA" sha mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e Operatorit ekonomik "inAuto" shpk ku argumentohet se: "...Operatori ekonomik ka propozuar motoçikleta me të dhëna teknike, të cilat nuk përmbushin kërkesat minimale teknike të përcaktuara shprehimisht në dokumentet e tenderit, pasi gjatësia e motoçikletës nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, çka përbën një mospërputhje thelbësore me kriteret teknike të vendosura nga AK... ", KSHA arsyeton se:*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se qëllimi i kërkesës në DST për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi nuk është vetëm dorëzimi formal i një dokumenti, por sigurimi i provave konkrete se artikujt e ofruar i përgjigjen nevojave dhe kërkesave reale të Autoritetit Kontraktor.*

*Në këtë kuadër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Operatori ekonomik "inAuto" shpk., konkretisht:*

*"Katalog\_mjete\_paisje\_skede\_teknike";*

*-"Deklarate\_origjine\_dhe\_CoC";*

*Nga shqyrtimi i katalogut, rezulton se nuk jepet informacion lidhur me disa prej specifikimeve teknike si Gjatësia, Gjerësia, Lartësia dhe Distanca e akseve. Nga shqyrtimi i dokumentit "Deklarate\_origjine\_dhe\_CoC" konstatohen këto përmasa:*

*Gjatësia           2195 mm*

*Gjerësia            945 mm*

*Lartësia            1470 mm*

*Distanca e akseve 1520 mm*

*Referuar përmasave të përcaktuara në Certifikatën e Konformitetit CoC konstatohet se gjatësia e mjetit është më e vogël se minimumi i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 6 të DT (Min 2250 mm). Gjithashtu nga shqyrtimi i katalogut, rezulton se për helmetën e paraqitur,*

model "KELLETT KL-822 FULL FACE HELMET" përcaktohet vetëm "Double Visor System", por në asnjë moment nuk përcaktohet të jetë e tipit "Modulare Kappa" me Xham + Syze të brendshme, si dhe me pjesën e përparme (mjekrës) të ngritshme, ashtu siç është kërkuar në Shtojcën 6. Sqarohet se "Double Visor System" nënkupton se helmata përbëhet nga një xham i jashtëm primar, transparent, i prodhuar zakonisht nga polikarbonat rezistent ndaj goditjeve dhe gërvishtjeve, dhe një xham i brendshëm sekondar i integruar (sun visor), me trajtim të errësuar (syze të brendshme) për mbrojtje nga dielli, i komanduar përmes një mekanizmi rrëshqitës ose levë anësore. Syzet e brendshme janë të tërheqshme dhe lejojnë adaptim të shpejtë ndaj ndryshimeve të ndriçimit pa nevojën e ndërrimit të xhamit të jashtëm. Sistemi është projektuar dhe konceptuar për të optimizuar fushëpamjen e përdoruesit, për të ofruar mbrojtje ndaj rrezatimit ultraviolet dhe për të ruajtur integritetin strukturor të helmetës. Ky konfigurim garanton funksionalitet ergonomic dhe siguri operative në përputhje me standartet bashkëkohore të pajisjeve mbrojtëse.

Në rastin tipit "Modulare Kappa", integrimi i "Double Visor System", dhe mekanizmit të artikullimit të pjesës së mjekrës është një zgjidhje funksionale që balancon kërkesat për mbrojtje, ventilim dhe ndërveprim verbal gjatë përdorimit, duke u mundësuar në këtë mënyrë përdoruesve lehtësi gjatë ushtrimit të detyrave të tyre funksionale në kuadër të komunikimit me qytetarët.

Gjithashtu, KSHA konstaton se katalogu i paraqitur lidhur me helmetën e paraqitur, model "KELLETT KL-822 FULL FACE HELMET" nuk përmban informacion të qartë, të plotë dhe të verifikueshëm, i cili të mundësojë identifikimin e saktë të artikullit të ofruar dhe krahasimin e tij me specifikimet teknike të kërkuara në mënyrë që të krijojë bindjen për përputhshmërinë teknike të produktit të ofruar.

Në përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, gjykon se, katalogu i paraqitur nga Operatori ekonomik "inAuto" shpk, paraqet mangësi që çënojnë përmbushjen e specifikimeve teknike e rrjedhimisht edhe përmbushjen e kontratës, duke mos garantuar realizimin e saj në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara sipas Shtojcës 6 të Dokumenteve të Tenderit.

***Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.***

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

## **VENDOSI**

*1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik "MOTO TIRANA" sha.....*

II.9. Vendimin nr. 32/2026, datë 03.03.2026 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik, "Moto Tirana" SHA, autoriteti kontraktor e ka praqitur në KPP edhe përmes shërbimit postar, i cili u protokollua me tonën me nr. 534/4 prot., datë 05.03.2026.

II.10. Në datën 09.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6401 dhe nr.750/2026 prot, datë 10.03.2026 i operatorit ekonomik “inAuto 2000” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73301-12-24-2025, me objekt: “Blerje motoçikletash për Policinë e Shtetit”, me fond limit 34,359,316.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 28.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit nr.32/2026, datë 03.03.2026 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, për pranimin e plotë të ankesës nr.534 prot., datë 20.02.2026 të operatorit ekonomik ankimues “Moto Tirana” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “InAuto” SHP” në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.11. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 750/1 prot., datë 10.03.2026.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Moto Tirana” SHA mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorit ekonomik “inAuto” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1.Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në datën 03.03.2026, autoriteti kontraktor, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr. 32/2026, datë 03.03.2026 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik, “Moto Tirana” SHA. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur pranimin e plotë të saj, duke argumentuar: [...]

II.2 Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues “MOTO TIRANA” sha mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga OE “inAuto” shpk, ku argumentohet se: “...Nga verifikimi i historikut të aktivitetit të shoqërisë inAuto, përfshirë të dhënat zyrtare të regjistruara pranë institucioneve shtetërore Competente, rezulton se veprimtaria e tyre është e fokusuar ekskluzivisht në tregtimin e automjeteve dhe se aha nuk ksnë ushtruar aktivitet në fushën e shtitjes apo furnizimit me motoçikleta... ”, KSHA arsyeton se:

Në Dokumentat Standarte të Tenderit të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimi , në Shtojcën 8, Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, është përcaktuar se:

**OFERTUESI DEKLARON SE:**

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;....

KSHA konstaton se mbështetur në objektin e prokurimit si dhe referuar Specifikimeve Teknike të parashikuara sipas Shtojcës 6 të DTS, natyra dhe objekti i kontratës ka të bëjë me furnizimin me motoçikleta.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit se "Ne kemi bindje se shoqëria inAuto shpk nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, pasi kjo shoqëri sipas ekstraktit të aksesueshëm në faqen e QKB-së <https://qkb.gov.al/kerko-per-subjekt/> rezulton të mos ketë objektin e tregtisë së moto-mjeteve ku përfshihen edhe objekti i procedurës së prokurimit", KSHA pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Operatori ekonomik "inAuto" shpk në SPE arsyetonte se:

Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, "Shkaqet e përjashtimit", gërma "A" "Deklarata për përmbushjen e kriteve të përgjithshme të kualifikimit", Operatori ekonomik "inAuto" shpk ndër të tjera ka deklaruar:

"Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme InAuto SHPK është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Adresa ëeb: Informacioni i nevojshëm mund të merret nga Qendra Kombëtare e

Biznesit <https://qkb.gov.al/>; <https://e-albania.al>

Autoriteti ose organi leshues: Qendra Kombëtare e Biznesit

Lloji i dokumentit: Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" dhe Ekstrakti historik për të dhënat e subjektit "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", Certifikatë Regjistrimi

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga shoqëria në rast se kualifikohet i pari ose në cdo rast që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor."....

Nisur nga përkufizimi ligjor, KSHA gjykon se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor ka detyrimin ligjor që të shqyrtojë e të vlerësojë ofertat sipas dokumentacionit provues të paraqitur nga OE në momentin e ofertimit. Rrjedhimisht çdo ndryshim oferte nga ofertuesi apo çdo kërkesë për ndryshim me qëllim kualifikimi përbën në vetvete modifikim të ofertës, ku referuar Nenit 92, pika 2 të LPP-së nuk lejohet.

Pra, për sa më sipër cituar, në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe në momentin e paraqitjes së ofertave, operatori ekonomik i shpallur fitues nuk e kishte të përfshirë në ekstraktin e tij tregtar fushën e veprimtarisë që lidhet me objektin konkret të prokurimit. Ky fakt është lehtësisht i verifikueshëm nga dokumentacioni zyrtar i regjistrimit tregtar dhe përbën një element thelbësor për vlerësimin e ligjshmërisë së kualifikimit të tij. Aftësia për të ushtruar një veprimtari të caktuar nuk është një element formal apo deklarativ, por një kusht ligjor që buron nga regjistrimi i subjektit në organet përkatëse. Objekti i veprimtarisë i përcaktuar në

ekstraktin e regjistrimit tregtar përfaqëson kufirin juridik brenda të cilit subjekti është i autorizuar të operojë. Për rrjedhojë, nëse në momentin e ofertimit operatori nuk e kishte të përfshirë aktivitetin që përkon me objektin e kontratës, ai nuk ishte juridikisht i autorizuar për ta ushtruar atë veprimtari dhe, si pasojë, nuk plotësonte kriteret e pranueshmërisë në procedurën e prokurimit, objekt ankimimi.

Parimi themelor në prokurimin publik është që kriteret e kualifikimit duhet të përmbushen në momentin e dorëzimit të ofertës. Procedura e prokurimit është një garë që zhvillohet mbi bazën e kushteve të barabarta dhe të verifikueshme në një pikë të caktuar kohore. Nuk është e lejueshme që një operator ekonomik të plotësojë apo të korrigjojë mungesa thelbësore pas hapjes së ofertave, e aq më pak gjatë fazës së shqyrtimit të ankesës. Lejimi i një praktike të tillë do ta zhvendoste momentin e përmbushjes së kriterëve nga koha e ofertimit në një fazë të mëvonshme, duke cenuar sigurinë juridike të procesit. Nga dokumentacioni i paraqitur gjatë fazës së ankimimit rezulton se operatori ekonomik e ka shtuar fushën e veprimtarisë në ekstrakt vetëm pasi është paraqitur ankesa, si pjesë e paraqitjes së argumentimeve përkatëse. Ky ndryshim, i kryer pas zhvillimit të tenderit, nuk mund të ketë efekt prapaveprues dhe nuk mund të shërbejë për të legjitimuar një gjendje juridike që nuk ekzistonte në momentin vendimtar të ofertimit. Në të kundërt, do të pranohej në mënyrë implicite që kriteret e kualifikimit mund të plotësohen edhe pas shpalljes së fituesit, gjë që bie ndesh me parimet e transparencës, barazisë së trajtimit dhe konkurrencës së ndershme.

Kjo situatë nuk përbën një mangësi formale apo një pasaktësi dokumentare që mund të korrigjohet, por një mungesë thelbësore që lidhet drejtpërdrejt me kapacitetin ligjor të operatorit për të realizuar objektin e kontratës. Ndryshimi i objektit të veprimtarisë gjatë fazës së ankimimit përforcon pikërisht faktin se në momentin e ofertimit kjo veprimtari nuk ishte e përfshirë dhe, për rrjedhojë,

nuk ishte e autorizuar. Pranimi i këtij ndryshimi si i vlefshëm do të krijonte një precedent të rrezikshëm, duke i vendosur operatorët ekonomikë në kushte të pabarabarta.

Në rastin konkret, zgjerimi i objektit të veprimtarisë së shoqërisë pas procesit të ofertimit, konsiderohet si një përpjekje për të modifikuar ofertën me synimin e qartë për ta kthyer atë nga një ofertë e pavlefshme në të vlefshme, çka bie në kundërshtim me parimet e sanksionuara në legjisllacionin e prokurimit publik.

Për më tepër, referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Operatori ekonomik i shpallur fitues paraprak, ka deklaruar, nën përgjegjësi të plotë ligjore, se përmbush të gjitha kriteret e kualifikimit dhe se disponon kapacitetin ligjor për të realizuar objektin e kontratës. Në kushtet kur në datën e ofertimit aktiviteti përkatës nuk figuronte në objektin e veprimtarisë së regjistruar, rezulton se deklarimi i bërë në formular nuk përputhej me gjendjen reale juridike të operatorit në atë moment, duke qenë rrjedhimisht i pasaktë. Gjithashtu, fakti gjatë fazës së ankimimit, operatori ekonomik "inAuto" shpk, ka shtuar fushën e veprimtarisë në ekstraktin tregtar e bën të pavlefshëm deklarin përkatës sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në momentin e zhvillimit të procedurës, objekt ankimimi.

Në përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave citon se, Operatori ekonomik nuk plotësonte kriteret e kërkuara në momentin e paraqitjes së ofertës, ndërsa deklarimi i bërë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton i pasaktë në raport me gjendjen ligjore ekzistuese. Shtimi i mëvonshëm i fushës së veprimtarisë gjatë fazës së ankimimit nuk mund të shërbejë për të legjitimuar një mungesë thelbësore dhe as për të korrigjuar një deklarin që në momentin e dhënies së tij ishte i pasaktë.

## ***Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.***

*II.2 Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues "MOTO TIRANA" sha mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e Operatorit ekonomik "inAuto" shpk ku argumentohet se: "... Mallrat e furnizuara nga kompania inAuto nuk përmbushin kriterin në lidhje me furnizimet e ngjashme dhe zërat e mallrave të paraqitura nga kjo kompani nuk mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit ...", KSHA arsyeton se:*

*Në Dokumentet Standarte të Tenderit të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1, është përcaktuar se:*

*"1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*c. a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*d. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*..... Pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit provues të paraqitur për përmbushjen e kërkesës për përvojën e ngjashme, rezulton se shoqëria "inAuto" shpk ka kryer furnizime për automjete në emër dhe për llogari të institucioneve publike. Kjo përvojë e ngjashme e dëshmuar nga ky Operator ekonomik lidhet ngushtësisht me objektin e ushtrimit të veprimtarisë së kësaj shoqërie, evidentuar kjo nëpërmjet Ekstraktit historik lëshuar gjatë momentit të ofertimit si dhe shqyrtimit e vlerësimit të ofertave. Referuar këtij dokumenti, Objekti i kësaj shoqërie lidhet me shitjen e automjeteve të reja dhe të përdorura, automobila, furgona, kamionë, autobusë, mjete të rënda pune, eskvatore, fadroma kamiona dhe agregate në përdorimin e tyre, koka prerese dhe pajisje shtese, për funksione specifike nga automjetet në fushën e ndertimit, automjete për përdorim të vecantë, automjete për trajtimin e mbetjeve, mjete dhe automjete bujqesore, automjete industriale, aktivitet koncesionar dhe përfaqësim i markave të ndryshme, shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje automjetesh dhe mjete të rënda, autoriparim, servis i rregullt, pjesë këmbimi, lubrifikante dhe aksesore automjetesh, shitje me shumicë dhe pakicë e pjesëve të këmbimit, tregtimi i gomave me shumicë dhe pakicë, këshillim për blerje, leasing dhe financim automjetesh, pjesëmarrje në tendera dhe kontrata publike, import dhe eksport automjetesh dhe pjesësh këmbimi, sallone dhe ekspozita automjetesh, transport dhe logjistikë automjetesh, qiradhenie automjetesh trajnime dhe certifikime për personelin teknik.*

*Gjithashtu, nga një analizë krahasimore, rezulton se shoqëria "inAuto" shpk ka kryer furnizime për automjete dokumentuar kjo nëpërmjet faturave elektronike të paraqitura nga ky Operator nga ku evidentohen qartë zërat e artikujve për kontratat publike të deklaruara.*

*Theksojmë se në Specifikimet Teknike të parashikuara sipas Shtojcës 6 të DTS, si dhe referuar Shtojcës 7 të DST, ku janë përcaktuar artikujt e kërkuar, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar se natyra dhe objekti i kontratës së prokurimit ka të bëjë me furnizimin me motoçikleta.*

*Për sa më sipër, KSHA vlerëson se përvoja e ngjashme, si kriter thelbësor kualifikues, duhet të jetë në përputhje me të plotë dhe të drejtpërdrejtë me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, duke ecur paralelisht me të. Kapaciteti ligjor dhe teknik i Operatorit ekonomik kufizohet qartazi nga objekti i veprimtarisë i regjistruar në Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar.*

*Për rrjedhojë, një Operator ekonomik nuk mund të pretendojë apo të provojë përvojë të vlefshme në fusha që tejkalojnë objektin e tij të regjistruar, pasi theksojmë se kjo do të binte ndesh me parimin e sigurisë juridike dhe me vetë konceptin e kapacitetit profesional.*

*Në rastin konkret, rezulton se objekti i prokurimit nuk është i përfshirë në objektin e veprimtarisë së shoqërisë "inAuto" shpk. Për pasojë, dokumentacioni i paraqitur prej saj në funksion të provimit të përvojës së ngjashme nuk plotëson kërkesën për përputhshmëri materiale me objektin e prokurimit, sipas zërave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarte të prokurimit Mungesa e kësaj përputhshmërie përbën një mangësi thelbësore, e cila ndikon drejtpërdrejtë në vlerësimin e kapacitetit teknik dhe profesional të Operatorit ekonomik.*

*KSHA konstaton se, referuar objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, kjo e fundit nuk ka mundur të provojë përmbushjen në mënyrë kumulative të tre elementëve të përvojës së ngjashme, të parashikuara sipas Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 4. Për më tepër, pranimi i një oferte që nuk përmbush kriteret e vendosura do të çënonte drejtpërdrejtë parimin e barazisë në kuptim të trajtimit të barabartë të Operatorëve ekonomik si dhe transparencën e procedurës, duke krijuar një avantazh të padrejtë në raport me Operatorët ekonomik që kanë përmbushur në mënyrë të plotë dhe rigorozë kërkesat e parashikuara nga Autoritetit Kontraktor.*

*Në përfundim, mosplotësimi qoftë edhe i njërit prej kriterëve të vendosura nga Autoriteti Kontraktor sjell si pasojë pavlefshmërinë e ofertës, pasi Operatori ekonomik ka detyrimin ligjor të paraqesë dokumentacion të plotë, të saktë dhe në përputhje me dokumentet e tenderit. Çdo devijim nga këto kërkesa përbën shkak të mjaftueshëm për skualifikim.*

***Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.***

*II.3 Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues "MOTO TIRANA" sha mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e Operatorit ekonomik "inAuto" shpk ku argumentohet se: "... Shoqëria inAuto shpk Çertifikatën ISO 9001:2015 "Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë" (e vlefshme) ose ekuivalente nuk e ka në përputhje me objektin e prokurimit, pasi organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë për të lëshuar këtë certifikatë i referohen objektit të veprimtarisë së subjekteve duke u bazuar në Ekstraktin e shoqërisë, objekt veprimtarie i cili nuk rezulton në këtë ekstrakt...", KSHA arsyeton se:*

*Në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 4, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar se: "4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:*

*ISO 9001:2015 "Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë" (e vlefshme) ose ekuivalent."*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se qëllimi i kërkesës për paraqitjen e certifikatës ISO 9001:2015, nuk është vetëm dorëzimi formal i një dokumenti, por është provë e zbatimit të*

*një Sistemi të Menaxhimit të Cilësisë, lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë e cila duhet të jetë e vlefshme në momentin e paraqitjes së ofertës.*

*ISO 9001:2015, si një standart ndërkombëtar përcakton kërkesat për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të cilësisë, duke garantuar kontrollin e proceseve, menaxhimin e riskut dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës organizative.*

*Në kuadër të vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se çertifikata e paraqitur nga Operatori ekonomik duhet të përmbushë në mënyrë kumulative këto kushte:*

*të jetë lëshuar nga një organ çertifikues i akredituar sipas legjislacionit përkatës;*

*të mbulojë në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë fushën e veprimtarisë që lidhet me objektin e prokurimit;*

*të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave.*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim Çertifikatën ISO 9001:2015 të paraqitur në SPE nga Operatori ekonomik "inAuto" shpk, konstatoi se kjo Çertifikatë është e zbatueshme në fushën e mëposhtme të aktivitetit të saj: "Import - eksport, tregtim dhe shpërndarje, pjesë këmbimi për mjete motorrike, lubrifikantë, goma, bateri, automjete, automjete të rënda, industriale e teknologjike, gjeneratorë, transformatorë, sisteme sigurie, pajisje elektrike, elektronike, industriale, hotelerie e mobilimi për të gjitha fushat e përdorimit. Furnizim, riparim dhe mirëmbajtje për të gjitha tipet e mjeteve lëvizëse e lundruese. Projektim, Supervizion dhe Punime në infrastrukturën civile e industriale."*

*Për sa më sipër, KSHA vlerëson se çertifikimet e Operatorëve ekonomik, lëshohen në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë të pasqyruar sipas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar. Ndodhur në kushtet ku objekti i prokurimit, nuk përfshihet në objektin e veprimtarisë së shoqërisë (fakt ky i evidentuar nëpërmjet Ekstraktit Historik), logjikisht dhe automatikisht ky objekt prokurimi nuk përfshihet në objektin e Çertifikatës ISO 9001:2015.*

*Në rastin konkret, referuar përmbajtjes së Çertifikatës ISO të paraqitur nga shoqëria "inAuto" shpk, rezulton se fusha e veprimtarisë së pasqyruar në këtë çertifikatë nuk përfshin aktivitetet që lidhen me objektin e prokurimit, i cili ka të bëjë në vetvete me furnizim motoçikletash.*

*Në këtë mënyrë, kjo çertifikatë e paraqitur nga Operatori ekonomik nuk përmbush funksionin provues për të cilin është kërkuar duke mos garantuar në këtë mënyrë kapacitetin organizativ dhe teknik për realizimin e kontratës me sukses.*

*Në përfundim, KSHA gjykon se duke qenë se kushtet në lidhje me certifikimin duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe të plotë, mospërputhja materiale e fushës së çertifikimit me objektin e prokurimit, çënon parimin e proporcionalitetit e për rrjedhojë mosplotësimi i këtij elementi nuk mund të konsiderohet si mangësi formale apo e korrigjueshme.*

*Për sa më lart, KSHA konstaton se Operatori ekonomik "inAuto" shpk nuk ka mundur të provojë përmbushjen e kriterit për paraqitjen e Çertifikatës ISO 9001:2015 në përputhje materiale me objektin e prokurimit.*

***Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.***

*II.4 Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues "MOTO TIRANA" sha mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e Operatorit ekonomik "inAuto" shpk ku argumentohet se: "...Operatori ekonomik ka propozuar motoçikleta me të dhëna teknike, të cilat nuk përmbushin kërkesat minimale teknike të përcaktuara*

shprehimisht në dokumentet e tenderit, pasi gjatësia e motoçikletës nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, çka përbën një mospërputhje thelbësore me kriteret teknike të vendosura nga AK... ", KSHA arsyeton se:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se qëllimi i kërkesës në DST për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi nuk është vetëm dorëzimi formal i një dokumenti, por sigurimi i provave konkrete se artikujt e ofruar i përgjigjen nevojave dhe kërkesave reale të Autoritetit Kontraktor.

Në këtë kuadër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Operatori ekonomik "inAuto" shpk., konkretisht:

"Katalog\_mjete\_paisje\_skede\_teknike";

-"Deklarate\_origjine\_dhe\_CoC";

Nga shqyrtimi i katalogut, rezulton se nuk jepet informacion lidhur me disa prej specifikimeve teknike si Gjatësia, Gjerësia, Lartësia dhe Distanca e akseve. Nga shqyrtimi i dokumentit "Deklarate\_origjine\_dhe\_CoC" konstatohen këto përmasa:

Gjatësia 2195 mm

Gjeresia 945 mm

Lartesia 1470 mm

Distanca e akseve 1520 mm

Referuar përmasave të përcaktuara në Certifikatën e Konformitetit CoC konstatohet se gjatësia e mjetit është më e vogël se minimumi i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 6 të DT (Min 2250 mm). Gjithashtu nga shqyrtimi i katalogut, rezulton se për helmetën e paraqitur, model "KELLETT KL-822 FULL FACE HELMET" përcaktohet vetëm "Double Visor System", por në asnjë moment nuk përcaktohet të jetë e tipit "Modulare Kappa" me Xham + Syze të brendshme, si dhe me pjesën e përparme (mjekrës) të ngritshme, ashtu siç është kërkuar në Shtojcën 6. Sqarojmë se "Double Visor System" nënkupton se helmata përbëhet nga një xham i jashtëm primar, transparent, i prodhuar zakonisht nga polikarbonat rezistent ndaj goditjeve dhe gërvishtjeve, dhe një xham i brendshëm sekondar i integruar (sun visor), me trajtim të errësuar (syze të brendshme) për mbrojtje nga dielli, i komanduar përmes një mekanizmi rrëshqitës ose levë anësore. Syzet e brendshme janë të tërheqshme dhe lejojnë adaptim të shpejtë ndaj ndryshimeve të ndriçimit pa nevojën e ndërrimit të xhamit të jashtëm. Sistemi është projektuar dhe konceptuar për të optimizuar fushëpamjen e përdoruesit, për të ofruar mbrojtje ndaj rrezatimit ultraviolet dhe për të ruajtur integritetin strukturor të helmetës. Ky konfigurim garanton funksionalitet ergonomik dhe siguri operative në përputhje me standartet bashkëkohore të pajisjeve mbrojtëse.

Në rastin tipit "Modulare Kappa", integrimi i "Double Visor System", dhe mekanizmit të artikullimit të pjesës së mjekrës është një zgjidhje funksionale që balancon kërkesat për mbrojtje, ventilim dhe ndërveprim verbal gjatë përdorimit, duke u mundësuar në këtë mënyrë përdoruesve lehtësi gjatë ushtrimit të detyrave të tyre funksionale në kuadër të komunikimit me qytetarët.

Gjithashtu, KSHA konstaton se katalogu i paraqitur lidhur me helmetën e paraqitur, model "KELLETT KL-822 FULL FACE HELMET" nuk përmban informacion të qartë, të plotë dhe të verifikueshëm, i cili të mundësojë identifikimin e saktë të artikullit të ofruar dhe krahasimin e tij me specifikimet teknike të kërkuara në mënyrë që të krijojë bindjen për përputhshmërinë teknike të produktit të ofruar.

Në përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, gjykon se, katalogu i paraqitur nga Operatori ekonomik "inAuto" shpk, paraqet mangësi që çënojnë përmbushjen e specifikimeve

*teknike e rrjedhimisht edhe përmbushjen e kontratës, duke mos garantuar realizimin e saj në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara sipas Shtojcës 6 të Dokumenteve të Tenderit.*

***Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.***

### **PËR KËTO ARSYE**

*Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,*

### **VENDOSI**

*1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik "MOTO TIRANA" sha.....*

III.1.2. Në datën 09.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6401 dhe nr.750/2026 prot, datë 10.03.2026 i operatorit ekonomik "inAuto 2000" SHPK, për procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-73301-12-24-2025, me objekt: "Blerje motoçikletash për Policinë e Shtetit", me fond limit 34,359,316.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 28.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit nr.32/2026, datë 03.03.2026 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, për pranimin e plotë të ankesës nr.534 prot., datë 20.02.2026 të operatorit ekonomik ankimues "Moto Tirana" SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik "InAuto" SHP" në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit,

III.1.3. Neni 30 i LPP-së i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : *"1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

**Referuar vendimmarrjes së KSHA-së për ankesën e operatorit ekonomik “Moto Tirana” SHA, lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “inAuto” SHPK, e cila ka vendosur pranimin e plotë të saj, KPP, bazuar në nenin 115, pika 3/b të LPP, do të vijojë shqyrtimin në themel të ankesës së pranuar nga autoriteti kontraktor, për të cilën subjekti i interesuar “inAuto” SHPK ka paraqitur argumente dhe më pas ankesë mbi këto argumente.**

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “inAuto ” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, me arsyen se :[...] *Operatori ekonomik nuk plotësonte kriteret e kërkuara në momentin e paraqitjes së ofertës, ndërsa deklarimi i bërë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton i pasaktë në raport me gjendjen ligjore ekzistuese. Shtimi i mëvonshëm i fushës së veprimtarisë gjatë fazës së ankimimit nuk mund të shërbejë për të legjitimuar një mungesë thelbësore dhe as për të korrigjuar një deklaram që në momentin e dhënies së tij ishte i pasaktë,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit” pika 1/a, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

....

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.*

III.2.2. Në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit , në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

#### Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezultojnë, se operatori ekonomik ankimes “inAuto”SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formular Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të plotësuar dhe nënshkruar, ku për kriterin 1/a ka deklaruar:

#### Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

##### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

#### Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* InAuto SHPK është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

*Adresa web:* Informacioni i nevojshëm mund të merret nga Qendra Kombëtare e Biznesit <https://qkb.gov.al>

*Autoriteti ose organi leshues:* Qendra Kombëtare e Biznesit

*Lloji i dokumentit:* Ekstrakti i Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” dhe Ekstrakti historik për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, Certifikatë Regjistrimi  
Dokumentacioni provues do të paraqitet nga shoqëria në rast se kualifikohet i pari ose në cdo rast që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.2.5 Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me

*transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.2.6 Neni 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” i VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se:

*“Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.*

*Këto kriteret synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”*

III.2.7. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

*Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.2.8. Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...” .

III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për 14 përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.10. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyen se nuk ka të përfshirë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “inAuto”SHPK, se në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në Pjesën II, “*Shkaqet e përjashtimit*”, gërma “A” “*Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit*”, është deklaruar sikurse paraqitet në pikën III.2.3 të këtij vendimi. Gjithashtu, nga verifikimi i Ekstraktit historik të regjistrimit për të dhënat e subjektit “inAuto” SHPK, të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton, se objekti i aktivitetit është përcaktuar: “*Shitja e automjeteve të reja dhe të përdorura, automobile, furgona, kamionë, autobusë, mjete të rënda pune, eskvatore, fadroma kamiona dhe agregate ne perdorimin e tyre, koka prerese dhe pajisje shtese, per funksione specifike nga automjetet ne fushen e ndertimit , automjete per perdorim te vecante, automjete per trajtimin e mbetjeve, mjete dhe automjete bujqesore, automjete industriale, aktivitet koncesionar dhe përfaqësim i markave të ndryshme, shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje automjetesh dhe mjete të rënda, autoriparim, servis i rregullt, pjesë këmbimi , lubrifikante dhe aksesore automjetesh, shitje me shumicë dhe pakicë e pjesëve të këmbimit, tregtimi i gomave me shumicë dhe pakice, këshillim për blerje, leasing dhe financim automjetesh, pjesëmarrje në tendera dhe kontrata publike, import dhe eksport automjetesh dhe pjesësh këmbimi, sallone dhe ekspozita automjetesh, transport dhe logjistikë automjetesh, qiradhenie automjetesh trajnime dhe certifikime për personelin teknik.*” Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “inAuto” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar formulari i përgjithshëm i vetëdeklarimit, lidhur me objektin e veprimtarisë së tij, si dhe në objektin e veprimtarisë së shoqërisë “inAuto” SHPK, sipas ekstraktit historik si më sipër cituar rezulton, se përfshihet objekti i prokurimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “inAuto ” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, me arsyen se *nuk përmbush kriterin në lidhje me furnizimet e ngjashme*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 “*Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit*”, kapaciteti teknik, pika 2.3.1, pjesë e dokumenteve të tenderit, rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

*1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*e. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*f. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Ndërsa, në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, “*Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit*” është parashikuar si më poshtë:

#### **Sasia e mallit që kërkohet:**

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Shuma</b>	<b>Destinacioni</b>	<b>Periudha e dorëzimit</b>
1	<b>Motoçikleta</b>	Copë	23	Qendra e Furnizimit Materialo Teknike e Policisë së Shtetit	<b>45 ditë.</b>

III.3.2. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm operatorit ekonomik “inAuto” SHPK ka ngarkuar:

- Vërtetim nr.784 prot., datë 26.08.2025, “Vërtetim për realizim kontrate”, lëshuar nga Bashkia Elbasan për realizim me sukses të kontratës “Blerje makina elektrike” me vlerë xxx lekë, shoqëruar me faturën tatimore nr.74/2025, datë 18.08.2025;
- Vërtetim nr.442/1 prot., datë 15.04.2025, “Vërtetim realizimi”, lëshuar nga Instituti I Ndëritmit për realizim me sukses të kontratës me objekt “Blerje automjete për nevojat e Institutit të Ndëritimit”, me vlerë xxx lekë, shoqëruar me faturën tatimore nr.57/85/2025, datë 11.04.2025;

- Vërtetim nr.1186 prot., datë 16.12.2025, “Kthim përgjigje kërkesës për realizim” , lëshuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për realizim me sukses të kontratës “Blerje automjeti për Kontrollin e lartë të Shtetit” me vlerë xxx lekë1, shoqëruar me faturën tatimore nr.102/2025, datë 02.12.2025;

III.3.3. Në nenin 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.3.4. Në nenin 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se: *“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore<sup>37</sup>, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara”*

III.3.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes

dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.6. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e furnizimeve të mëparshme të ngjashme ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin dëshmi për furnizimeve të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit për të cilin ata konkurrojnë, në një vlerë jo më pak se se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës dhe që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat e mallrave, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë kushtin e përcaktuar në nenin 40, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë se ka kryer shërbime të ngjashme me sukses të një ose disa kontratave në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, që prokurohet. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Kontratat e ngjashme, që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, jo më të vogël se 40% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshme eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues. Për përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin e paraqitur në pikën III.3.2. të këtij vendimi, kontrata, fatura tatimore elektronike, ku evidnetohen sasia, njësia, përshkrimi i mallit të ofruar, vlera pa Tvsh e shprehur në monedhën lekë. KPP gjykon, se në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit, lidhet me blerje motorçikletash.

KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues, parë kjo në rrafshin krahasimor me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponentë do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 3 vjeçar nga data e njoftimit të

kontratës), komponenti vlerë (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.2.1 pra në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të fondit limit, si dhe komponentit natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga operatori ekonomik me objektin e prokurimit,). Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra ligjëvënësi në nenin 40 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara dhe në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Fillimisht KPP vlerëson të sqarojë faktin se, pavarësisht se kontratat dhe faturat e paraqitura nga operatori ekonomik “inAuto” SHPK janë në emër të operatorit ekonomik “CompiTel” SHPK, nga verifikimi i ekstraktit të regjistrimit historik të operatorit ekonomik ankimes “inAuto” SHPK rezulton se, në datën 09.09.2025 me vendim të Asamblesë datë 08.09.2025 emri i subjektit është ndryshuar ishte “CompiTel” u bë “inAuto”. Për rrjedhojë, kontratat dhe faturat e paraqitura vlerësohen të rregullta, pavarësisht emrit që mbajnë në momentin e lëshimit.

Nga verifikimi i furnizimeve të ngjashme të mëparshme të realizuara dhe dokumentacioni shoqëruar i tyre, i paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se operatori ekonomik “InAuto” SHPK ka kryer furnizime të ngjashme të përmendura në pikën III.3.2. të këtij vendimi, me objekt blerje automjetesh. Në lidhje me elementin kohë, faturat tatimore elektronike të paraqitura nga operatori ekonomik “InAuto” SHPK të realizuara me sektorin publik janë brenda afatit kohor 3 vjeçar, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës së procedurës objekt – ankimi, e cila është publikuar më datë 29.12.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike. Lidhur me komponentin e ngjashmërisë, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave tatimore të shitjes, të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “inAuto” SHPK, KPP vlerëson se, me anë të faturave tatimore të dorëzuara dëshmon se ka kryer furnizime të natyrës së shitjes së mallrave objekt – prokurimi. Kontratat e realizuara nga operatori ekonomik “inAuto” SHPK me objekt “Blerje automjete” konsiderohen kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit “Blerje motorcikletash”, pasi ka përputhshmëri në natyrën e furnizimit, funksionin dhe kërkesat teknike. Lidhur me komponentin e vlerës, vlera e faturave të paraqitura (18,750,000 lekë) është më e madhe se vlera (40% e vlerës së fondit limit, ose 13,743,726 lekë) e kërkuar nga autoriteti kontraktor. KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre faturave, rezulton, se këto fatura konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, pra operatori ekonomik ka arritur që të dorëzojë dëshmi që ka realizuar furnizime të ngjashme. Sa më sipër, KPP vlerëson, se faturat tatimore të dorëzuara nga operatori ekonomik ankimes plotësojnë të tre komponentët kumulativ në interpretim të kriterit kualifikues. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “inAuto” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “inAuto ” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, me arsyen se *Çertifikata Iso 9001:2015 e paraqitur nuk përfshin aktivitetin që lidhet me objektin e prokurimit*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 8 “*Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit*”, kapaciteti teknik, pika 2.3.4, pjesë e dokumenteve të tenderit, rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

4. *Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:*
  - *ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;*

III.4.2. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “inAuto” SHPK ka ngarkuar: Certifikatë e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 lëshuar nga e-Cert; nr. Certifikatës SMC20240328ALCS, me datë skadimi 27.03.2026, në gjuhën shqipe;

III.4.3.. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) *të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) *të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) *të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) *të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) *të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) *të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.4.4. Neni 3 Parime të përgjithshme “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.4.5. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, e Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

*“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.*

*8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

III.4.6. Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” përcaktohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..”.*

II.4.7. Në nenin 44 “Kërkesa e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

*2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një 30 mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37 të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

3. *Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*
4. *Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkojnë një certifikatë ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/të barasvlershme me të ose një dokument që provon të njëjtin informacion.*
5. *Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.”.*

III.4.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.9. Në rastin konkret, referuar dokumentave standarte të tenderit, konkretisht seksionit 2 Objekti i Kontratës pika 2.2 “*Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)*” autoriteti kontraktor ndër të tjera ka përcaktuar: 34410000-4. Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në seksionin “*Të tjera*”, në rubrikën “*Kodet CPV*” përcaktohen grupi i kodeve, emërtimi i kodit CPV dhe Identifikimi i kodit CPV për procedurat e prokurimit elektronik. Sa më sipër, në grupin e kodit “*Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash*” bën pjesë edhe edhe

emertimi i kodit 34410000-4 dhe identifikimi i kodit Motorcikleta, ndërkohë që objekti i veprimtarisë për të cilën është certifikuar operatori ekonomik ankimues me certifikata ISO 9001:2015, përfshin fushat [...] pjesë këmbimi për mjete motorrike, lubrifikantë, goma, bateri, automjete, automjete të rënda, industriale e teknologjike [...], përkatëse ku secili nga këto objekte është i identifikueshëm me kodet respektive EA: 28, 29, 35, kode të cilat referuar VKM nr. 320, datë 28.05.2014 “Për miratimin e nomenklaturës së veprimtarive ekonomike të Revizionuara (Rev 2)” kanë në përbërje disa nënkategori apo klasa NACE, nga verifikimi i të cilave rezulton se, kodit 29 i certifikatës përfshin objektin e procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues nuk qëndron, pasi certifikata ISO 9001:2015, e paraqitur nga operatori ekonomik “inAuto” SHPK e plotëson kriterin kualifikues të përcaktuara në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi në fushën e veprimtarisë së këtyre certifikatave referuar kodeve është i përfshirë objekti i prokurimit, i përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në pikën 2, të Seksionit 2 “Objekti i Kontratës” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt-prokurimi sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatave ISO 9001:2015. Në këto kushte KPP gjykon, se operatori ekonomik “inAuto” SHPK plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikat 2.3.4 “Kapacitetin teknik” të shtojcës 8/2 “Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “inAuto” SHPK qëndron

III.5 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “inAuto ” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, me arsyen se *gjatësia e mjetit është më e vogël se minimumi i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 6 të DT (min 2250mm)*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 8 “Formulari i kriteve të përzgjedhjes/kualifikimit”, kapaciteti teknik, pika 2.3.5, pjesë e dokumenteve të tenderit, rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

5. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mallrave të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.*

Ndërsa në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, ku për motrocikletat 1055 CC ka përcaktuar si më poshtë:

**Motocikleta 1050 CC, prodhim minimum i 3 (tre) viteve të fundit.**

Mjetet duhet të jenë të reja dhe të pa përdorura.

- **Përmasat;**

<b>Gjatesia</b>	Min 2250 mm
<b>Gjeresia</b>	Min 800 mm
<b>Lartesia</b>	Min 1400 mm
<b>Distanca e akseve</b>	Min 1400 mm
<b>Lartesia e shales</b>	Min 830 mm
<b>Lartesia nga toka</b>	Min 160 mm
<b>Pesha bosh</b>	Min 210 kg
<b>Depozita e benzines</b>	Minimumi 19 litra

- **Motorri;** Me 4-kohe, ftohje me uje/ajër

<b>Vellimi i motorrit</b>	Minimumi 1035 cc
<b>Fuqia motorike</b>	Min 75 KË
<b>Lubrifikimi</b>	Me pomp vaji
<b>Ignition</b>	Me injeksion elektronik
<b>Sistemi i ushqimit</b>	Fuel injection
<b>Kontroll digital të motorrit :</b>	DTC (Kontrolli dinamik i tërheqjes)
· 3 mënyra kalërimi (ECO, Shi dhe Rrugë jo asfalt)	
<b>Ndezja</b>	Elektrike
<b>Eisioni (Emetimi i gazrave)</b>	Min Euro 5

- **Transmisioni** me 6-marshe

<b>Transmisioni</b>	Zinxhir ose transmision
<b>Amortizatorët para</b>	Teleskopik me vaj
<b>Amortizatorët prapa</b>	Te regjistrueshem me vaj

- **Sistemi i frenimit** Me dy disqe, sistem DCC (Kontroll adaptiv me funksion frenimi)

<b>Frenat para</b>	Disk, dysh
<b>Frena prapa</b>	Disk
<b>Gomat para</b>	R 19
<b>Gomat e pasme</b>	R 17

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimes "inAuto" SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Shtojca 8 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" ku operatori ekonomik ka plotësuar Pjesën III "Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit" A: Deklaratë "Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës".
- Dokumentin me emërtimin " Katalog\_mjete\_paisje\_skede\_teknike"
- Deklarate\_origjine\_dhe\_CoC

III.4.3. Në neni 77, pika 1 dhe 4 "Kërkesat për kualifikim" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.4.4. Në nenin 40 pika 6 germa b) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

[...]

III.4.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.4.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, ka përcaktuar specifikimet teknike të cilat duhet të përmbushin mallrat objekt prokurimi. Konkretisht për **Motoçikleta 1050 CC ka parashikuar përmasat ku gjatësia është përcaktuar Min 2250 mm**. Gjithashtu, në “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 e “Kapacitetit teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi, ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mallrave të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së

KPP konstaton se, qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet katalogëve/skedë teknike nga prodhuesi, të verifikohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, për të parë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “inAuto” SHPK, konstaton se, ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, katalogun e mjetit të ofruar dhe aksesoreve, si dhe deklarate origjine dhe çertifikata e conformitetit ku janë markuar specifikimet e kërkuara në shtojcën 6 të dokumentave të tenderit, Lidhur me gjatësinë e motorcikletës, specifikim teknik i cili është përdorur nga autoriteti kontraktor si arsye skualifikimi, nga verifikimi i dokumentave të paraqitura nga operatori ekonomik, certifikata e conformitetit konstatohet se, gjatësia e pasqyruar në këtë dokument 2195 mm është më e vogël se ajo e kërkuar në dokumentat e tenderit 2250 mm.

Pretendimi i ankimesit se ndonëse gjatësia prej 2195 mm në certifikatën e konformitetit paraqet dimensionin bazë të homologimit, gjatësia reale e mjetit në konfigurimin funksional me elementët standardë arrin vlerën e kërkuar prej 2250 mm dhe për këtë arsye specifikimi teknik konsiderohet i përmbushur nuk qëndron. *Së pari*, kërkesa në DST është e qartë dhe konkrete: gjatësia e mjetit duhet të jetë 2250 mm. Ndërkohë, OE ka paraqitur një mjet me gjatësi 2195 mm. *Së dyti*, dokumenti CoC (Certificate of Conformity) është dokumenti zyrtar i homologimit dhe përfaqëson referencën më të saktë dhe të standardizuar për parametrat teknikë të mjetit. Autoriteti kontraktor, me specifikimin teknik “gjatësia 2250 mm”, nënkupton pikërisht parametrat e verifikueshëm në dokumentacionin zyrtar teknik (si CoC), dhe jo vlerësime hipotetike apo interpretative mbi konfigurime të ndryshme. Për rrjedhojë, mjeti i paraqitur nga OE me gjatësi 2195 mm nuk përmbush specifikimin teknik prej 2250 mm. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimes është në kushtet e mospërmbushjes së kritereve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt – ankimi.

Për sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "MotoTirana" SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik "inAuto" SHPK për arsye se :[...] *Përveç mospërputhjes me specifikimet kryesore teknike, operatorët ekonomikë në fjalë ne mendojmë se nuk përmbushin as kërkesat lidhur me pajisjet shtesë të detyrueshme të motoçikletave. Konkretisht, oferta e paraqitur nuk përfshin ose nuk garanton përputhje me specifikimet e kërkuara për valixhet anësore të motoçikletave, si dhe për sistemet e sinjalizimit zanor dhe vizual, përfshirë sirenat dhe pajisjet përkatëse të alarmit, të cilat janë të domosdoshme për përdorim policor.[...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se*

III.5.1. Sipas vendimit të KSHA lidhur me këtë pretendim rezulton se: *[Gjithashtu nga shqyrtimi i katalogut, rezulton se për helmetën e paraqitur, model "KELLETT KL-822 FULL FACE HELMET" përcaktohet vetëm "Double Visor System", por në asnjë moment nuk përcaktohet të jetë e tipit "Modulare Kappa" me Xham + Syze të brendshme, si dhe me pjesën e përparme (mjekrës) të ngritshme, ashtu siç është kërkuar në Shtojcën 6. Sqarojmë se "Double Visor System" nënkupton se helmata përbëhet nga një xham i jashtëm primar, transparent, i prodhuar zakonisht nga polikarbonat rezistent ndaj goditjeve dhe gërvishtjeve, dhe një xham i brendshëm sekondar i integruar (sun visor), me trajtim të errësuar (syze të brendshme) për mbrojtje nga dielli, i komanduar përmes një mekanizmi rrëshqitës ose levë anësore. Syzet e brendshme janë të tërheqshme dhe lejojnë adaptim të shpejtë ndaj ndryshimeve të ndriçimit pa nevojën e ndërrimit të xhamit të jashtëm. Sistemi është projektuar dhe konceptuar për të optimizuar fushëpamjen e përdoruesit, për të ofruar mbrojtje ndaj rrezatimit ultraviolet dhe për të ruajtur integritetin strukturor të helmetës. Ky konfigurim garanton funksionalitet ergonomic dhe siguri operative në përputhje me standartet bashkëkohore të pajisjeve mbrojtëse.*

*Në rastin tipit "Modulare Kappa", integrimi i "Double Visor System", dhe mekanizmit të artikullimit të pjesës së mjekrës është një zgjidhje funksionale që balancon kërkesat për mbrojtje, ventilim dhe ndërveprim verbal gjatë përdorimit, duke u mundësuar në këtë mënyrë përdoruesve lehtësi gjatë ushtrimit të detyrave të tyre funksionale në kuadër të komunikimit me qytetarët.*

*Gjithashtu, KSHA konstaton se katalogu i paraqitur lidhur me helmetën e paraqitur, model "KELLETT KL-822 FULL FACE HELMET" nuk përmban informacion të qartë, të plotë dhe të verifikueshëm, i cili të mundësojë identifikimin e saktë të artikullit të ofruar dhe krahasimin e tij me specifikimet teknike të kërkuara në mënyrë që të krijojë bindjen për përputhshmërinë teknike të produktit të ofruar.*

*Në përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, gjykon se, katalogu i paraqitur nga Operatori ekonomik "inAuto" shpk, paraqet mangësi që çenojnë përmbushjen e specifikimeve teknike e rrjedhimisht edhe përmbushjen e kontratës, duke mos garantuar realizimin e saj në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara sipas Shtojcës 6 të Dokumenteve të Tenderit.*

III.5.2. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci

juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 3 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim interpretim sistematik (domethënjën e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 113 i ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor lidhur me këtë vendimmarrje nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik. Në rastin konkret rezulton se pretendimet e shoqërisë “Moto Tirana” SHA përsa i përket shoqërisë “inAuto” SHPK, lidhen me mospërmbushjen e këtij të fundit të *specifikimeve të kërkuara për valixhet anësore të motoçikletave, si dhe për sistemet e sinjalizimit zanor dhe vizual, përfshirë sirenat dhe pajisjet përkatëse të alarmit, të cilat janë të domosdoshme për përdorim policor*, ndërkohë që rezulton se autoritetit kontraktor nuk i referohet këtij specifikimi teknik në shqyrtimin e ankesës, por gjykon mbi bazën e specifikimeve të tjera për të cilat nuk ka pretendime dhe konkretisht është gjykuar mbi *helmetën e paraqitur*. Sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyet e reja të skualifikimit dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, janë në tejkalim të kompetencave që u jep shprehimisht neni Neni 94 i VKM nr.285 datë 19.05.2021 dhe nuk sjellin asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik “inAuto” SHPK e si të tilla nuk merren në shqyrtim nga KPP.

III.5.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “MotoTirana” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “inAuto”SHPK për arsye se :[...] *Përveç mospërputhjes me specifikimet kryesore teknike, operatorët ekonomikë në fjalë ne mendojmë se nuk përmbushin as kërkesat lidhur me pajisjet shtesë të detyrueshme të motoçikletave. Konkretisht, oferta e paraqitur nuk përfshin ose nuk garanton përputhje me specifikimet e kërkuara për valixhet anësore të motoçikletave, si dhe për sistemet e sinjalizimit zanor dhe vizual, përfshirë sirenat dhe pajisjet përkatëse të alarmit, të cilat janë të domosdoshme për përdorim policor*.[...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.4. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë KPP, operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e specifikimeve teknike nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.5.5. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitimit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

III.2.3. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili, në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.5.6. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.5.7 Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.5.8. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientë e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krahasim të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrajnë pretendime a-priori duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kritereve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicicion procedurën, barra e provës*

*për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.5.9. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.5.10 KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Moto Tirana”SHA nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Moto Tirana” SHA në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-73301-12-24-2025, me objekt: “Blerje motoçikletash për Policinë e Shtetit”, me fond limit 34,359,316.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 28.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “inAuto” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “inAuto” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.

4. Autoriteti kontraktor brenda pesë ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
  5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Moto Tirana” SHA dhe operatori ekonomik “inAuto”SHPK.
  6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

